



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr. 103/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “ASHA” SH.P.K., me seli në Prishtinë, rr. “Garibaldi”, hy. 3, kati 2 nr.7/1, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Agron Selimaj, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve me seli në Prishtinë, rr. “Nëna Terezë”, e përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, për shkak të anulimit të Vendimit nr. 12/2023 të datës 09.02.2023 dhe Vendimit nr.01/2023 të datës 05.01.2023, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 04.12.2023, në prezencë të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, me datë 11.12.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “ASHA” SH.P.K., kundër të paditurit Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve.
- II. NDRYSHOHET Vendimi nr. 12/2023 i datës 09.02.2023 i nxjerrë nga i padituri Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, ashtu që aprovet ankesa me numër protokolli 45/2023 e datës 10.01.2023 e ushtruar nga shtëpia filmike “ASHA” SH.P.K dhe ANULOHET Vendimi nr. 01/2023 i datës 05.01.2023, i nxjerrë nga Qendra Kinematografike e Kosovës.
- III. Mbetet në fuqi Vendimi KD. nr. 51/2022 i datës 30.12.2022 i nxjerrë nga Qendra Kinematografike e Kosovës.
- IV. Ky Aktgjykim i zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter detyrues.
- V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “ASHA” SH.P.K., me seli në Prishtinë, pranë kësaj gjykate ka iniciuar konflikt administrativ me kërkesë për anulimin e Vendimit nr. 12/2023 të datës 09.02.2023 dhe Vendimit nr.01/2023 të datës 05.01.2023, i nxjerr nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve (MKRS) Qendra Kinematografike e Kosovës (QKK). Sipas padisë, paditësi ka aplikuar në

konkursin e hapur nga data 15.07.2022 deri më 19.08.2022 nga i padituri për subvencionimin e projekteve kinematografike të filmit të metrazhit të gjatë artistik për vitin 2022. Lidhur me këtë paditësi thekson se i padituri më 30.12.2022 kishte nxjerr vendim me të cilin kishte subvencionuar projektin filmik “Pilivesa” të paditësit me kuotën 166,770.00 €, mirëpo ky vendim disa ditë më vonë ishte anuluar nga vet i padituri me arsyetimin se kriter i konkursit kishte qenë që regjisorët që nuk e kanë përfunduar fazën e xhirimit të filmit të përkrahur më parë nga QKK, gjegjësisht regjisori D. Zh. ka qenë regjisorë i filmit “Hotline” i përkrahur më parë nga QKK dhe nuk është xhiruar. Sipas paditësit i padituri në mënyrë të kundërligjshme ka shtuar një kriter ashtu që në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë ka ardhur deri tek konstatimi i gjendjes faktike. Për më tepër, sipas paditësit përmes parashtresës nr.347/2022 të datës 13.07.2022 regjisori D. Zh. është njoftuar nga producenti dhe pronari i shoqërisë tregtare – shtëpisë filmike “Möbius” se projekti “Hotline” nuk do të realizohet për shkak të dështimit për të siguruar fonde shtesë. Tutje ka shtuar se kufizimi i pjesëmarrjes, përmes kriterit “regjisorët të cilët nuk e kanë përfunduar fazën e xhirimit të filmit të përkrahur më parë nga QKK, nuk ka të drejtë pjesëmarrje në cilësinë e regjisorit” është i kundërligjshëm pasi që një kriter i tillë nuk është paraparë me Rregulloren nr.07/2016, respektivisht nenin 9. Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësorë përmes përfaqësuesit të autorizuar ka deklaruar se i padituri në kundërshtim me nenin 13 të Rregullores 07/2016 për subvencionimin e projekteve filmike ka shtuar një kriter më tepër në konkursin e projekteve filmike për vitin 2022. Sipas paditësit kriteri i shtuar në pikën 7 të konkursit tërësisht është në kundërshtim të kufizimeve dhe dispozitave ligjore për pjesëmarrjen në konkurs, nga nën paragrafët e nenit 13 të kësaj rregullore askund nuk kufizohet që regjisorët të cilët nuk kanë përfunduar fazën e xhirimit të mos kenë të drejtë pjesëmarrje në cilësinë e regjisorit. Ka shtuar se edhe nga raporti i komisionit për shqyrtimin e dokumenteve për projektet filmike të paraqitur në përgjigje të padisë shihet se paditësi ka plotësuar të gjitha kërkesat dhe kriteret e konkursit. Gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe të anuloj vendimet kontestuese nr. 12/2023 të datës 09.02.2023 dhe nr. 01/2023 të datës 05.01.2023 dhe të mbetet në fuqi vendimi nr. 51/2022 i datës 30.12.2022 për subvencionimin e projektit filmik “Pilivesa”.

I padituri përmes përgjigjes në padi e ka kontestuar në tërësi padinë e paditësit duke i propozuar gjykatës që ta refuzoj në tërësi si të pabazuar padinë e paditësit dhe të lë në fuqi vendimin e të paditurit MKRS-së, si të drejtë dhe të ligjshëm. Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor nuk ka prezantuar, mirëpo përmes parashtresës për deklarim në seancë ka deklaruar se konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj në tërësi

si të pabazuar padinë e paditësit dhe të lë në fuqi Vendimin nr.12/2023 të datës 09.02.2023 të MKRS-së.

Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Konkurs për film të metrazhit të gjatë-artistik (mbi 60min) Ref.nr. QKK 01/2022; Lista e projekteve të përzgjedhura nga juritë vlerësuese për projektet filmike të konkursit 2022 i datës 07.12.2022; Vendim KD.nr. 51/2022 i datës 30.12.2022; Vendim KD.nr. 01/2023 i datës 05.01.2023; Ankesë e datës 10.01.2023; Vendim nr. 12/2023 i datës 09.02.2023; Kërkesë nr. Ref. 347/2022 i datës 13.07.2022; Raport nr. Ref. 439/2022 i datës 08.09.2022.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pretendimeve të palëve ndërgjyqëse në seancë, thënieve në padi dhe përgjigjen në padi të paditurve si dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresave tjera të lëndës, gjeti se kërkesëpadija e paditësit është tërësisht e bazuar.

Gjykata konstatoi se paditësi kishte marr pjesë në konkursin për film të metrazhit të gjatë të shpallur nga i padituri, për çka ky i fundit kishte nxjerr vendimin nr.51/2022 të datës 30.12.2022 me të cilin kishte vendosur që të subvencionoj paditësin për projektin filmik “Pilivesa”, mirëpo ky vendim ishte anuluar me datë 05.01.2023.

Ndaj vendimit nr.01/2023 të datës 05.01.2023, paditësi kishte ushtruar ankesë e cila ishte refuzuar me Vendimin nr. 12/2023 të datës 09.02.2023 dhe vendimi i atakuar kishte mbetur në fuqi, me arsyetimin se subvencionimi i projektit “Pilivesa” ishte bërë në kundërshtim me kriterin e konkursit, i cili kishte përcaktuar se regjisorët të cilët nuk kanë përfunduar fazën e xhirimit të filmit të përkrahur më parë nga QKK, nuk kanë të drejtë pjesëmarrje në cilësinë e regjisorit, pasi që regjisori i projektit filmik D. Zh. kishte qenë regjisorë i projektit filmik “Hotline” i përkrahur në vitin 2019 nga QKK dhe nuk është xhiruar.

Paditësi i pakënaqur me këtë vendim, ka ushtruar padi në gjykatë, duke e kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit.

Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton se: *“Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative.”* dhe nenit 13 par.1 i cili përcakton se:

“Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë.”

Nga Konkursi për film të metrazhit të gjatë-artistik (mbi 60min) Ref.nr. QKK 01/2022, gjykata ka konstatuar i padituri ka shpallur konkurs publik për film të metrazhit të gjatë – artistik, ku ka përcaktuar kufizimet në pjesëmarrje dhe atë duke përfshirë njëmbëdhjetë kufizime: “1. Shtëpitë filmike dhe producentët që janë me vonesë në zbatimin e kontratës me QKK-në për projektet e fituara më parë, nuk kanë të drejtë pjesëmarrjeje. 2. Shtëpitë filmike nuk kanë të drejtë konkurrimi me më shumë se dy projekte brenda vitit, projektet duhet të jenë të kategorive. 3. Një producent ka të drejtë të aplikojë vetëm një projekt brenda vitit. 4. Një regjisor ka të drejtë të aplikojë me vetëm një projekt brenda vitit. 5. I njëjti person nuk mund të jetë regjisorë dhe producent i të njëjtit projekt. 6. Regjisorit dhe producentit që konkurrojnë me projekt të filmit të metrazhit të gjatë artistik duhet t'i kenë të realizuar së paku nga dy projekte të metrazhit të shkurtër ose një të gjatë. 7. Regjisorët të cilët nuk e kanë përfunduar fazën e xhirimit të filmit të përkrahur më parë nga QKK, nuk kanë të drejtë pjesëmarrjeje në cilësinë e regjisorit. 8. Personat që aplikojnë në cilësinë e regjisorit në një projekt, nuk kanë të drejtë të aplikojnë në cilësinë e producentit në një projekt tjetër dhe anasjelltas. 9. Filmat televiziv të metrazheve dhe zhanreve të ndryshme nuk kanë të drejtë pjesëmarrje/aplikimi. 10. Projektet që janë refuzuar dy here nuk kanë të drejtë aplikimi. 11. Si dhe kriteret tjera të parapara me Ligin për Kinematografi dhe Rregulloren për subvencionimin e projekteve filmike të QKK-së”. Konkursi ka qenë i hapur nga data 15.07.2022 deri më 19.08.2022.

Nga Lista e projekteve të përzgjedhura nga juritë vlerësuese për projektet filmike të konkursit 2022 i datës 07.12.2022, gjykata ka konstatuar se projekti “Pilivesa” nga shtëpia filmike “ASHA” me producent A. Z. dhe regjisor D. Zh., ishte përzgjedhur nga juria vlerësuese në kuadër të kategorisë film i metrazhit të gjatë artistik.

Nga Vendim KD.nr. 51/2022 i datës 30.12.2022, gjykata ka konstatuar se i padituri kishte subvencionuar projekti “Pilivesa” nga shtëpia filmike “ASHA” me producent Alban Zogjani dhe regjisor e skenarist D. Zh., ku kuota e subvencionimit kishte qenë 166,440.00€ (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e dyzet euro).

Nga Vendimi KD.nr. 01/2023 i datës 05.01.2023, gjykata ka konstatuar i padituri kishte anuluar vendimin KD.nr. 51/2022 të datës 30.12.2022, me arsyetimin se subvencionimi i projektit “Pilivesa” ishte bërë në kundërshtim me kriterin e konkursit i cili kishte përcaktuar se regjisorët të cilët nuk kanë përfunduar fazën e xhirimit të filmit të përkrahur më parë nga QKK, nuk kanë të drejtë pjesëmarrjeje në cilësinë e regjisorit, pasi që regjisorit i projektit filmik D. Zh. kishte

qenë regjisorë i projektit filmik “Hotline” i përkrahur në vitin 2019 nga QKK i cili nuk është xhiruar.

Nga Ankesa e datës 10.01.2023, gjykata ka konstatuar se paditësi kishte ushtruar ankesë ndaj vendimit KD.nr. 01/2023 i datës 05.01.2023 duke kërkuar që të mbetet në fuqi vendimi mbi përkrahjen e projektit “Pilivesa”, me arsyetimin se kriteri i shtuar nga i padituri kishte qenë i kundërligjshëm, meqë i njëjti nuk është përcaktuar me Ligjin për Kinematografinë dhe as me Rregulloren për subvencionimin e projekteve filmike.

Nga Vendimi nr. 12/2023 i datës 09.02.2023, gjykata ka konstatuar se i padituri kishte refuzuar ankesën e paditësit duke lënë në fuqi vendimin e atakuar me ankesë, duke mbështetur arsyetimin e dhënë në vendimin për anulimin e vendimit me të cilin ishte subvencionuar projekti “Pilivesa”.

Nga Kërkesa nr. Ref. 347/2022 e datës 13.07.2022, gjykata ka konstatuar se kompania “Möbius” i ishte drejtuar të paditurit me kërkesën për shkëputjen e kontratës për subvencionimin e projektit “Hotline” për shkak të dështimit të sigurimit të mjeteve shtesë, projekt në të cilin po ashtu kishte qenë regjisor D. Zh..

Nga Raporti nr. Ref. 439/2022 i datës 08.09.2022, gjykata ka konstatuar se i padituri kishte përpiluar raport mbi shqyrtimin e dokumentacionit të projekteve të cilat nuk i kanë përmbushur kushtet për vazhdimin e konkurrimit.

Gjykata vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri nuk ka vepruar drejtë kur ka shtuar kriterin shtesë “7.Regjisorët të cilët nuk e kanë përfunduar fazën e xhimit të filmit të përkrahur më parë nga QKK, nuk kanë të drejtë pjesëmarrjeje në cilësinë e regjisorit”, në Konkursin për film të metrazhit të gjatë-artistik (mbi 60min) Ref.nr. QKK 01/2022.

Me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues gjykata iu referua nenit 33 të Ligji Nr.2004/22 për Kinematografinë, i cili përcakton se: *“Në përputhje me programin e aktiviteteve dhe potencialin financiar për vitin përkatës, jo më larg se dy muaj pas miratimit të mjeteve buxhetore, këshilli drejtues shpall konkurs për projekte filmike: për filma artistikë të metrazhit të plotë e të shkurtër, për filma dokumentarë dhe për filma vizatimorë-të animuar.*
33.2.Të drejtë pjesëmarrjeje në konkurs kanë të gjithë personat juridikë, vendës ose të huaj të regjistruar në Kosovë si subjekt biznesi për prodhimin e filmit (producentët filmikë), si dhe kineastët me statusin e artistit të lirë, nëse me këtë ligj nuk përcaktohet ndryshe. Nuk kanë të drejtë pjesëmarrjeje në konkurs punëtorët e QKK dhe anëtarët e Këshillit drejtues.
33.3.Procedurat e përzgjedhjes së projekteve rekomandohen nga këshilli drejtues, kurse

miratohen nga ana e Ministrit.”, po ashtu nenit 36 i cili parasheh: “Këshilli Drejtues, me propozim të drejtorit të QKK, çdo vit shpall konkurs për film artistik të metrazhit të shkurtë, për film dokumentar dhe për film vizatimor - të animuar, me të drejtë pjesëmarrjeje vetëm për kineastët e rinj që sapo kanë përfunduar arsimin universitar profesional. “ si dhe nenit 37, par. 1 i cili parasheh se: “1..Këshilli Drejtues miraton dhe subvencionon projekte filmike (duke përcaktuar edhe kuotën e subvencionit) në bazë të përzgjedhjes nga juria vlerësuese dhe raportit të komisionit financiar.

Gjykata po ashtu iu referua nenit 13 të Rregullores (MKRS) –Nr. 07/2016 për Subvencionimin e Projekteve Filmike nga Qendra Kinematografike e Kosovës, i cili përcakton kufizimet e pjesëmarrjes në konkurs: “1.Shtëpitë filmike që janë me vonesë në zbatimin e kontratës nuk kanë të drejtë pjesëmarrjeje. 2. Shtëpitë filmike nuk kanë të drejtë konkurrimi me më shumë se dy projekte brenda vitit. 3. Një producent ka të drejtë të aplikojë me vetëm një projekt brenda vitit.4. Një regjisorë ka të drejtë të aplikojë me një projekt brenda vitit. 5. I njëjti person nuk mund të jetë regjisorë dhe producent i të njëjtit projekt. 6. Regjisor i dhe producenti që konkurrojnë me projekt të filmit të metrazhit të gjatë artistik duhet të kenë së paku të realizuar nga dy projekte të metrazhit të shkurtër ose një të metrazhit të gjatë, përveç ata që konkurrojnë në konkursin për film të metrazhit të gjatë debutues dhe postproduksion. 7. Aplikimi për koproduksion minor mund të ndodhë vetëm atëherë kur projekti ka të siguarar së paku 70% të buxhetit. 8. Projekte që janë refuzuar dy herë nuk kanë të drejtë pjesëmarrjeje në QKK. 9. Filmat televizivë të metrazheve dhe zhanreve të ndryshme nuk kanë të drejtë pjesëmarrjeje/aplikimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret i padituri ka shtuar në mënyrë të kundërligjshme kriterin kufizues: “7.Regjisorët të cilët nuk e kanë përfunduar fazën e xhimit të filmit të përkrahur më parë nga QKK, nuk kanë të drejtë pjesëmarrjeje në cilësinë e regjisorit”, kjo pasi që sipas gjykatës një kriter i tillë nuk është i përcaktuar me Ligjin për Kinematografinë dhe as me Rregulloren për Subvencionimin e Projekteve Filmike nga Qendra Kinematografike e Kosovës.

Ligjshmërinë e aktit administrativ gjykata e vlerësoi edhe në përputhje me nenin 4 të Ligjit nr.05/L-031 i cili përcakton kufizimin e organeve publike që veprimtarinë tyre ta realizojnë brenda kompetencave të tyre. Në par. 1 të këtij nenit është përcaktuar se: “1. Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca.”. Po ashtu në par. 2 është përcaktuar se: “2.

Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj.”

Bazuar në këtë, gjykata vlerëson se autoriteti i organeve administrative, në këtë rast i të paditurit, duhet të shtrihet deri në atë masë sa nuk tejkalon kufijtë e kompetencës të cilat janë rregulluar me akt juridik, në rastin konkret kriteret janë përcaktuar në mënyrë taksative me Rregulloren për Subvencionimin e Projekteve Filmike nga Qendra Kinematografike e Kosovës.

Gjykata vendosi që të anulojë si të kundërligjshëm Vendimin nr. 12/2023 të datës 09.02.2023 dhe Vendimi nr.01/2023 të datës 05.01.2023, i nxjerrë nga i padituri Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve dhe të mbetet në fuqi Vendimi KD.Nr.51/2022 i datës 30.12.2022 në kuptim të nenit 43 të LKA-së i cili përcakton se: *“1. Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative. 2. Nëse gjykata konstaton se konflikti administrativ nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative për shkak se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta në akte, gjë që në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht, e që nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, ose konstaton se në procedurën administrative nuk janë respektuar rregullat e procedurës, që do të kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes, gjykata do të anulojë me aktgjykim aktin e kontestuar administrativ. Në një rast të tillë, organi kompetent ka për detyrë të veprojë ashtu si është caktuar në aktgjykim dhe të nxjerrë akt të ri administrativ. 3. Nëse anulimi i aktit administrativ, sipas paragrafit 2. të këtij neni dhe zhvillimi i përsëritur i procedurës në organin administrativ kompetent do të shkaktonte për paditësin ndonjë dëm, i cili me vështirësi do të riparohej, apo nëse në bazë të dokumenteve zyrtare ose të provave të tjera në shkresat e lëndës është e qartë se gjendja faktike ndryshon nga ajo që është vërtetuar në procedurën administrative, apo nëse në të njëjtin konflikt administrativ është anuluar një herë akti administrativ, kurse organi administrativ kompetent nuk ka vepruar sipas aktgjykimit, gjykata mundet edhe vetë të vërtetojë gjendjen faktike ose me anë të organit tjetër dhe në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nxjerr aktgjykimin, respektivisht vendimin”*. Andaj, gjykata duke pasur parasysh edhe urgjencën në trajtimin e ligjshmërisë së akteve kontestuese, meqë paditësi ka qenë përfitues i subvencionit gjatë vitit 2023 dhe se në vitin 2024 i padituri do të hap konkursin e ti për subvencionim konform nenit 36 të Ligjit për Kinematografinë i cili parasheh se: *“Këshilli Drejtues, me propozim të drejtorit të QKK, çdo vit shpall konkurs për film artistik të metrazhit të shkurtë, për film dokumentar dhe për film vizatimor - të animuar, me të drejtë pjesëmarrjeje vetëm për kineastët e rinj që sapo kanë përfunduar arsimin universitar profesional.”*, gjykata shqyrtoi

ligjshmërinë e akteve të goditura me padi në mënyrë meritore dhe vendosi vetë për çështjen, pasi që të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës kanë dhënë bazë të sigurt për vendosjen e çështjes administrativ nga gjykata.

Gjykata vendosi vetë për çështjen mbështetur në nenin 46 par. 4 të LKA-së i cili përcakton se: *“4. Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar”*. Në këtë drejtim, gjykata vlerëson se vendimet e atakuara me padi duhet të anulohen për shkak se i padituri nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat e lartcekura kur ka vendosur që të shtoj një kriter shtesë kufizues në Konkursin për film të metrazhit të gjatë-artistik (mbi 60min) Ref.nr. QKK 01/2022 duke i pamundësuar kështu paditësit subvencionimin për realizimin e projektit “Pilivesa”, ashtu që gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit duke lënë në fuqi Vendimin KD. nr. 51/2022 i datës 30.12.2022 me të cilin paditësi ishte subvencionuar në kategorinë e filmit të gjatë artistik për projektin “Pilivesa” në kuotën prej 166,770.00€.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr. 103/23, datë 11.12.2023

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.